

UDHËZIM

Nr. 7642, datë 17.11.2016

PËR PROCEDURAT E EKZEKUTIMIT MBI NJËSITË INDIVIDUALE QË PËRBËJNË STRUKTURËN QË DO TË NDËRTOHET DHE PËR TË CILAT DISPONOHEN KONTRATA SIPËRMARRJEJE/POROSIE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, si dhe të nenet 46 dhe 47, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe publikë në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij udhëzimi si vijon:

1. Kur në përfundim të procedurave përmbarimore, karabinaja kalon në pronësi të një kreditori dhe në regjistrin e veçantë nuk është regjistruar asnjë akt tjetër noterial, ose kontratë sipërmarrjeje/porosie/premtim shitjeje, sipas nenit 46, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, regjistruesi lëshon dokumente të përkohshme në favor të kryerjes së transaksioneve nga ana e kreditorit, i cili ka të drejtë të disponojë dhe të tjetërsojë me të tretët këtë pasuri, vetëm për ato njësi ndërtimore që janë të lira dhe nuk kanë akte noteriale të regjistruara më parë mbi to.

2. Në rastet kur në regjistrin e veçantë ku është i regjistruar objekti si karabina, janë të regjistruara kontrata sipërmarrjeje/porosie/premtim shitjeje, apo çdo akt tjetër noterial për njësitë ndërtimore të individualizuara, pjesë të strukturës së karabinasë, përmbaruesi nuk mund të vendosë sekuestro mbi këto njësi ndërtimore të individualizuara, objekt i këtyre kontratave.

3. Në rastet kur disponohet një kontratë sipërmarrjeje/porosie/premtim shitjeje, apo çdo akt tjetër noterial, i paregjistruar në regjistrin e veçantë në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, por vërtetohet se porositësi/blerësi ka kryer pagesa në zbatim të kontratës së sipërmarrjes/porosisë/premtim shitjes apo çdo akti tjetër noterial, përmbaruesi gjyqësor nuk mund të vendosë sekuestro mbi këto njësi ndërtimore, objekt i këtyre kontratave dhe nëse e ka vendosur, duhet të marrë masa të menjëhershme për përjashtimin apo heqjen e sekuestros nga këto njësi.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, të orientojë përmbaruesit gjyqësorë të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Ylli Manjani